

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

INTRAKOLL C2T GRI/BARDHË**Date: 19.05.2026****PËRSHKRIMI**

Ngjitës pllakash thiksotropik me bazë çimento, me forcë ngjitëse të përmirësuar. I përbërë nga rërë të përzgjedhur me granulometri të seleksionuar, aditivë të veçantë dhe polimere specifike. INTRAKOLL është i përshtatshëm për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Ofron ngjitje të shkëlqyer mbi suporte me bazë çimentoje, aplikim të shpejtë dhe të lehtë, si dhe rezistencë të lartë ndaj kushteve atmosferike.

KLASIFIKIMI SIPAS STANDARTIT

Ngjitës për pllaka me bazë çimentoje (C), me forcë ngjitëse të përmirësuar (2) dhe pa rrëshqitshmëri vertikale (T). I klasifikuar si ngjitës C2T, sipas standardit EN 12004.

INTRAKOLL karakterizohet nga emetime të ulëta të VOC-ve (komponime organike të avullueshme), duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së aplikatorëve, në përputhje me kërkesat e certifikimit ECI Plus.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikës, gres porcelanit etj. Përdoret për aplikime në dysheme dhe mure, si në ambiente të brendshme ashtu edhe të jashtme. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave me dimensione nga 5–60 cm.

MENYRA E PËRGATITJES SE PERZIERJES

Përzieri 6.5–7 litra ujë të pastër me 25 kg Intrakoll. Përziejeni masën e krijuar me një përzierës elektrik derisa të përftohet një masë homogjene, pa kokrriza. Lëreni përzierjen të pushojë për 10 minuta dhe më pas përziejeni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2–3 orë.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimentoje duhet të jenë të qëndrueshme, rezistente dhe të rrafshëta, pa prani vajrash, papastërtish apo mbetjesh boje, si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e nevojshme të maturimit. Dyshemetë tradicionale me bazë çimentoje, me kohë normale fortësimi, duhet të kenë një periudhë stazhionimi prej të paktën 28 ditësh, ndërsa suvatë tradicionale duhet të thahen për minimumi 14 ditë.

Disnivelet dhe çarjet e mëdha duhet të riparohen paraprakisht. Të gjitha llojet e suporteve duhet të pastrohen mekanikisht përpara aplikimit të produktit. Para aplikimit, sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet lehtë me ujë, në mënyrë që të sigurohet një ngjitje sa më e mirë dhe një kohë punueshmërie optimale e produktit.

APLIKIMI

Fillimisht rekomandohet që produkti të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës, për të siguruar një shpërndarje sa më të njëtrajtshme, dhe më pas të punohet me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi kryhet me një mallë të përshtatshme, në varësi të llojit dhe dimensionit të pllakës që do të vendoset.

Vendosja e pllakave realizohet duke ushtruar një presion të lehtë mbi to, duke siguruar mbulimin e plotë të sipërfaqes së pllakës me ngjitës. Koha e hapjes së produktit, në kushte atmosferike normale dhe në temperaturë 23°C, është rreth 35 minuta. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.

Duhet treguar kujdes që ngjitësi të mos formojë shtresë filmi në sipërfaqe. Nëse kjo ndodh, është e nevojshme që malla të kalohet përsëri mbi ngjitësin. Në sipërfaqet e bashkimit me muret vertikale duhet të lihet një hapësirë prej 5 mm.

TECHNICAL DATA SHEET

Issue: 1

Version: 2

INTRAKOLL C2T GRI/BARDHË
Date: 19.05.2026
TË DHËNAT TEKNIKE

| | |
|-----------------------------------|---|
| Pamja: | Pluhur |
| Paketimi: | Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg |
| Ngjyra: | E bardhë/Gri |
| Konsumi: | 3-5 kg/m ² |
| Magazinimi: | Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri |
| Koha e Magazinimit: | 12 muaj nga data e prodhimit |
| Masa Vëllimore: | 1.5-1.6 gr/cm ³ |
| Uji për përzierje: | 6.5-7 litra ujë për 25 kg |
| pH i përzierjes: | 13 |
| Temperatura e aplikimit: | +5°C deri në +35°C |
| Koha e korrigjimit: | 35 min |
| Mbushja e fugave në mure: | Pas 8 deri 12 orësh |
| Mbushja e fugave në dysheme: | Pas 24 orësh |
| FN* pas 28 ditësh: | ≥ 1 N/mm ² |
| FN* pas zhytjes në ujë: | ≥ 1 N/mm ² |
| FN* pas reaksionit nga ngrohja: | ≥ 1 N/mm ² |
| FN* pas cikleve ngrirje-shkrirje: | ≥ 1 N/mm ² |
| FN* pas 20 min: | ≥ 1 N/mm ² |
| I shkelshëm: | Pas 24 orësh |
| Rreshkitshmeria: | ≤ 0.5 mm |
| Reaksioni ndaj zjarrit: | Klasa A1 |

KUJDES!

Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përsheptim në tharje të produktit).

Mos e përdorni në:

1. Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
2. Për pllaka me dimensione të mëdha dhe të rënda.
3. Për ambiente me ngrohje qendrore, në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme, suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
4. Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë